



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ Prot.

Tiranë, _____.____.2022

VENDIM

Nr. 21, datë 30.05.2022

PËR

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN QARKULLUES
TË KËSHILLIT DREJTUES NR.13, DATË 09.04.2021 “PËR CAKTIMIN E
BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË “DELOITTE AUDIT
ALBANIA” SH.P.K. DHE “DELOITTE ALBANIA” SH.P.K., SI AUDITUESË TË
BRENDSHËM TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE, PËR VITET
FINANCIARE 2021-2024”**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 44, pika 2, të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 10, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të nenit 18 të Statutit të Agjencisë, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 5 dhe nenit 12 të Rregullores të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.16, datë 30.04.2020 “Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Në Vendimin Qarkullues të Këshillit Drejtues nr.13, datë 09.04.2021 “Për caktimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k. dhe “Deloitte Albania” sh.p.k., si audituesë të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për vitet financiare 2021-2024” bëhet ndryshimi i mëposhtëm:
 - a) Pika 3 e vendimit shfuqizohet.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj
Sekretare

Donald Duraj
Kryetar

